

VENDIM
Nr. 218, datë 13.4.2022

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 35, DATË 19.1.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOSSHME, PËR VITIN 2022, NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 1, të vendimit nr. 35, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjen “Gr. 11, Ministria e Arsimit dhe Sportit”, në ndarjen “Gr. 14, Ministria e Drejtësisë”, në ndarjen “Gr. 31, Agjencia Telegrafike Shqiptare” dhe në ndarjen “Gr. 87, institucione të tjera qeveritare” shtohen nënndarjet përkatëse, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Periudha kohore me 4 orë në ditë e punonjësve sanitarë në zyrat arsimore vendore, në ndarjen “Gr. 11, Ministria e Arsimit dhe Sportit”, bëhet 6 orë në ditë.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr. 1

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve 2022	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	1			
	Zyrat vendore arsimore Polican	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
14	Ministria e Drejtësisë	2			
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Operator	6 orë/ditë	vjetore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Punonjës Arkiv-Protokolli	6 orë/ditë	6 muaj
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	10			
	Agjencia Telegrafike Shqiptare	9	Specialist	6 orë / ditë	vjetore
	Agjencia Telegrafike Shqiptare	1	Teknik i mesëm	6 orë / ditë	vjetore
87	Institucione të tjera qeveritare	6			
	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	4	Specialist	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Rinisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës	1	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj

	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	19			
--	----------------------------	----	--	--	--